

Welcoming remarks

By

Dajana Berisha

Executive Director of FIQ

Faleminderit Berat,

Znj. dhe Zotërinj, mirëmbërëma dhe mirëse keni ardhë në mbrëmjen e filantropisë Kosovare.

Dëshiroj, që një përshëndetje të veçantë t'ua drejtoj Ambasadorëve **Znj. Tracy Ann Jacobson**, Ambasadore e SHBA-ve dhe **Z. Islam Lauka** Ambasador i Republikës së Shqipërisë, të cilët ndërmjet angazhimeve të tjera kanë zgjedhë të jenë të ftuarit special të FIQ – Ju faleminderit!

Z. Kim Mehmeti, shkrimtar, publicist dhe kritik i guximshëm, jemi të lumtur që, Ju, një ndër përfaqësuesit më dinjitoz të letrave shqipe, na nderoni me praninë tuaj,

Dr. Michael Mors, Zv.Drejtor i GIZ, e vlerësojmë bashkëpunimin dhe mbështetjen e zyrës suaj dhe është gjithmonë kënaqësi bashkëbisedimi dhe shkëmbimi i ideve me Drejtorin tuaj James Macbeth

Z. Haki Abazi, Drejtor i Programit të Ballkanit Perëndimor prej RBF, mirëmbërëma, faleminderit për besimin dhe mbështetjen tuaj,

E pra, Zonja dhe zotërinj,

Pjesëmarrja e të gjithëve ju në këtë ceremoni, na kujton dhe njëherë, se sa i vlefshëm është angazhimi ynë si shoqëri civile në përmbushjen e misionit të “promovimit të të mirës së përbashkët”, duke qenë të vetëdijshëm poashtu për përgjegjësinë dhe kontributin tonë në zhvillimin demokracisë së shëndetshme për Kosovën.

Forumi për Iniciativa Qytetare është organizatë jo fitimprurëse, që angazhohet për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për promovimin e filantropisë si

mekanizëm që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm sidomos në këto realitete të turbullta ekonomike dhe financiare në vend dhe rajon.

Andaj, jemi mbledhur sonte për të pestin vit radhazi, për të shprehë mirënjohje publike të gjithë atyre individëve, kompani vendase, apo të diasporës që përgjatë vitit 2013 janë angazhuar dhe kanë kontribuar në zgjidhjen e problemeve të natyrës sociale, arsimore, apo mjedisore të qytetarëve tanë.

Jemi të vetdijsëm, që jetojmë në një realitet kontradiktor, në të cilin tkurrja e burimeve të përbashkëta natyrore ndodh jo thjesht si pasojë e rritjes së nevojave të qytetarëve për konsum, por mbi të gjitha si rrjedhojë e keqmanaxhimit të këtyre pasurive.

Niveli i lartë i papunësisë, përpjekjet e qytetarëve Kosovarë për të emigruar qoftë dhe ilegalisht për një jetë më cilësore, nxisin nevojën urgjente për të projektuar dhe zbatuar modele të reja të zhvillimit ekonomik, që në terma afatgjatë do të ndikojnë në rimëkëmbjen ekonomike të vendit.

E një realitet i tillë duhet të shërbejë si presion, i nevojshëm ndaj institucioneve publike, biznesit dhe shoqërisë civile kosovare për të ideuar dhe promovuar, politika gjithëpërfshirëse, që nxisin mobilizimin e sektorit privat në përmbushjen me kujdes të këtyre nevojave.

Trekëndëshi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, sektorit privat dhe shoqërisë civile duhet të jetë thelbësor, i qënësish dhe plotësues në mënyrë që të mundësojë implementimin e një modeli ekonomik që do të vendosë në qendër të vëmendjes qytetarët.

Ronald Reagan, ish presidenti amerikan do të shprehej për rëndësinë e qeverisë si vijon: “Ne nuk duhet të kërkojmë zgjidhje të halleve tona prej qeverisë – Qeveria është vetë halli ”!

Në përmbushje të misionit tonë si shoqëri civile, jemi të përkushtuar për të punuar për të ardhmen, duke i thënë Jo “logjikës së të shkuarës” sipas së cilës, roli i shoqërisë civile, është sipërfaqësor dhe për të plotësuar një kuadër, apo standart të nevojshëm politik.

Më lejoni që në mbyllje të fjalës time, jo vetëm t'ju falenderoj për vëmendjen tuaj, por njëkohësisht, t'ju kujtoj dhe një detaj logjistik

Nxënësit e shkollës fillore “Naim Frashëri” në Prishtinë, do të mbledhin një fond modest në shkëmbim të ëmbëlsirave të përgatitura prej tyre vete. Ky fond modest do të shkojë për të pasuruar bibliotekën e shkollës “NF” me libra dhe tekste jashtëshkollore, të cilat synojnë jo vetëm pasurimin e fjalorit dhe të imagjinatës së nxënësve, por le të shpresojmë, që duke i afruar fëmijët më shumë me librin, i mbajmë ata për disa orë larg prej TV, dhe facebook-ut 😊.